



Vëllimi 5, Numri 5

qershor 2024

BULETINI KUNDËR TERRORIZMIT

PËR BALLKANIN, RRETH BALLKANIT

NË KËTË NUMËR

Lajme dhe informacione kundër terrorizmit
– 1

Shtetasi shqiptar gjykohe për financim të
terrorizmit - 2

Gjykata e Kosovës gjykon dhe dënon me
burg francezin për përgatitje të veprave
terroriste - 2

Shtetasi rus dënohet në SHBA me 12 vjet
burg për tentativë financimi të terrorizmit -
2

Një grua nga Nju Jork dënohet me 18 vjet
burg për përdorimin e kriptomonedhave
për financimin e grupeve terroriste në Siri –
2

SHBA riatdheson 11 shtetas amerikanë nga
Siria – 3

Raporti i Europolit: Propaganda xhihadiste
online - 2022 Analizë – 3



Lajme dhe informacione lidhur me terrorizimin për përditësimin dhe komunikimin mes partnerëve tanë në rajon

*Departamenti i Drejtësisë, Zyra e Ndihmës Zhvillimore dhe Trajnimit Prokurorial
(OPDAT) në partneritet me Departamentin Amerikan të Shtetit, Byroja e
Antiterrorizmit*

Në këtë numër njihemi me disa të reja rreth procedimeve dhe dënimeve të fundit të disa të dyshuarve dhe financuesve të terrorizmit në Ballkan dhe në Shtetet e Bashkuara (SHBA). Ky numër përmban gjithashtu edhe disa lajme mbi riatdhësimin e fundit të qytetarëve amerikanë nga Siria dhe mbi raportin e fundit të Europol-it për rekrutimin e xhihadistëve online. Buletini mbyllet me një përmbledhje rreth librit të Qendrës Ndërkombëtare të Anti-Terrorizmit mbi procedimin në rritje në Gjermani ndaj ekstremistëve të dhunshme femra të riatdhësuar nga Siria

Joe Baldwin
Këshilltar Ligjor Rajonal
Kundër Terrorizmit për Ballkanin
OPDAT/DOJ
Ambasada Amerikane
Tiranë
BaldwinJR@state.gov

Peter S. Jongbloed
Këshilltar Ligjor Rajonal
Kundër Terrorizmit për Ballkanin
OPDAT/DOJ
Ambasada Amerikane
Sarajevë
JongbloedPS@state.gov

Bledar Bashanoviq
Specialist Juridik
OPDAT/DD
Ambasada e SHBA
Tiranë
BashanoviqB@state.gov

Jasenska Ferizoviq
Këshilltare Juridike
OPDAT/DD
Ambasada e SHBA
Sarajevë
FerizovicJ@state.gov

Shtetasi shqiptar dërgohet për gjykim për financim të terrorizmit

Më 28 maj, një gjyqtar i procedurës paraprake nga Gjykata e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar miratoi dërgimin për gjykim të aktakuzës ndaj të pandehurit Muhamed Manollari, i dyshuar për financim terrorizmi, parashikuar nga neni 230/a i Kodit Penal Shqiptar. Sipas aktakuzës së ngritur në mars të këtij viti, Manollari i ka dërguar para babait të tij, MM, i cili ishte aktiv me Shtetin Islamik të Irakut dhe Sirisë (ISIS) (i njohur edhe si Shteti Islamik dhe Shteti Islamik i Irakut dhe Levantit) në Siri, duke e ditur se babai i tij dyshohej se nxiste dhe financonte terrorizmin në kuadrin e ISIS-it. Aktakuza pretendon se babai i Manollarit kishte promovuar ideologjinë terroriste të ISIS-it në një nga videot e rekrutimit të ISIS-it ku u bënë njerëzve thirrje që të bashkoheshin dhe të ndihmonin ISIS-in. Manollari dyshohet se kishte përdorur kredenciale dhe dokumente identiteti të vjedhura për të dërguar para përmes Western Union në nëntor 2018 përmes një ndërmjetësi me bazë në Siri.

Aktakuza është thjesht një pretendim. I pandehuri prezumohet i pafajshëm derisa të provohet fajësia përtej çdo dyshimi të arsyeshëm në gjykatë.

Burimi: Prokuroria e Posaçme kundër Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit në Shqipëri

Gjykata e Kosovës gjykon dhe dënon me burg një shtetas francez për përgatitje të veprave terroriste

Më 4 prill, një trup gjykues i Departamentit Special të Gjykatës Themelore të Prishtinës shpalli fajtor shtetasin Blend Vranjoll, banues në Francë, i akuzuar për kryerjen e veprës penale "Përgatitja e veprave terroriste". Më pas gjykata e dënoi me tre vjet e gjashtë muaj burg. Siç është raportuar në një buletin të mëparshëm, Vranjoll gjatë shkurtit të vitit 2023 kishte planifikuar të kryente akte terroriste në Kosovë me synim goditjen e aktiviteteve të komunitetit LGBT ose pikat e kontrollit ndërkufitar ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Vranjoll kishte komunikuar me disa persona në Siri përmes aplikacionit Threema dhe kishte marrë udhëzime nga terroristët për të përgatitur disa pajisje shpërthyes të improvizuara.

Gjykata në vendimin e saj të detajuar u shpreh se Vranjoll kishte kërkuar në internet për përmbajtje radikale dhe për teknika që ndihmonin për të fshehur identitetin e përdoruesit. Gjithashtu, gjykata konstatoi se, në një telefon që autoritetet franceze i kishin siguruar Kosovës, Vranjoll kishte komunikuar me një person kontakti në ISIS me emrin Al Muhaxher se si të merrte udhëzime hap pas hapi për marrjen e materialeve dhe për prodhimin e eksplozivëve dhe një droni që do të përdorej ndaj objektivave si parada e komunitetit LGBT në Prishtinë ose në kufirin me Serbinë.

Burimi: Prokuroria Speciale e Kosovës

Shtetasi rus dënohet në SHBA me 12 vjet burg për tentativë për financim të terrorizmit

Më 29 prill, Murat Kurashev, një shtetas rus me banim në Kaliforni, u dënua me 12 vjet burg për përpjekje për t'i ofruar mbështetje materiale organizatës Hayat Tahrir al-Sham (HTS), një organizatë e huaj e shpallur si organizatë terroriste. Në janar të këtij viti, Kurashev u shpall fajtor për veprën penale të dërgimit të disa transfertave parash që arrinin në rreth 13,000 dollarë dy korrierëve të njohur për mbledhje fondesh për llogari të organizatës HTS në periudhën korrik 2020 - shkurt 2021. Sipas aktakuzës, gjatë komunikimeve në mediat sociale dhe aplikacioneve të koduara të mesazheve me mbledhësit e fondeve, Kurashev ishte shprehur se do të dëshironte t'i bashkohej luftës në Siri si muxhahidin dhe se vinte keq që e vetmja gjë që mund të ofronte ishte mbështetja financiare. Kjo tregonte qartë ndërgjegjësimin e Kurashevit për ideologjinë e dhunshme ekstremiste të mbledhësve të fondeve dhe për punën që ata kryenin për llogari të HTS-së.

Analiza shkencore e provave të sekuestruara nga Kurashevi tregoi se ai ndiqte aktivitetin online të mbledhjes së fondeve, duke përfshirë edhe disa faqe që kërkonin fonde për blerje pajisjesh ushtarake. Aktiviteti i tij në internet përfshinte edhe eksplorimin e përmbajtjeve ekstremiste.

Burimi: [Shtetasi rus me banim në Sacramento dënohet me 12 vjet burg për tentativën e ofrimit të mbështetjes materiale një organizatë të huaj terroriste](#)

Një grua nga Nju Jorku dënohet me 18 vjet burg për përdorimin e kriptomonedhave për financimin e grupeve terroriste në Siri

Në prill 2024, Gjykata e Lartë e Shtetit të Nju Jorkut dënoi Victoria Jacobs, e njohur ndryshe si Bakhrom Talipov, me 18 vjet burg për përdorimin e kriptomonedhave për financimin e grupeve terroriste në Siri. Jacobs, 44 vjeç, nga Nju Jorku, u dënua në muajin shkurt për të gjitha akuzat e ngritura ndaj saj, duke përfshirë edhe mbështetjen financiare për grupet terroriste në Siri, ofrimin e mbështetjes për një akt terrorizmi dhe pastrimin e parave.

Provat në gjyq treguan se Jacobs i kishte dhënë më shumë se 6000 dollarë grupit terrorist të stërvitjes Malhama Tactical, i cili luftonte dhe ofronte stërvitje speciale taktike dhe ushtarake për organizatën e shpallur si organizatë terroriste, HTS. Ajo kishte pastruar 12,000 dollarë në emër të Malhama Tactical duke marrë kriptomonedha dhe transfertat me Western Union dhe MoneyGram nga mbështetësit në mbarë botën dhe ia kishte dërguar ato fonde organizatës Malhama Tactical në portofolat Bitcoin. Përveç kësaj, Jacobs kishte blerë edhe disa karta dhuratash të Google Play për HTS-në.

Gjithashtu, Jacobs i kishte dërguar edhe një Manual gjithëpërfshirës të Municioneve të Improvizuara të Ushtrisë Amerikane një grupi xhihadist online, Hurras al-Din, i cili besohet se ishte i lidhur si me HTS-në, ashtu edhe me al-Kaedwn, me qëllim që të ndihmonte në përpjekjet e tyre për prodhimin e bombave në Siri.

Dhe në fund, provat kishin treguar se në gusht 2021, Jacobs kishte blerë disa thika luftarake të stilit ushtarak dhe disa doreza metalike dhe mjete goditëse metalike në formë yjesh fluturuese. Përafërsisht një muaj më vonë, në një bisedë në Telegram, ajo dyshohet se ishte hequr si një "vëlla" që qëndronte "pas frontit armik" dhe kishte bërë thirrje për lutje që t'i jepnin "guxim, forcë, udhëzim dhe mençuri për të kryer disa misione".

Burimi: [DA Bragg: Victoria Jacobs dënohet me 18 vjet burg për përdorimin e kriptomonedhave për financimin e grupeve terroriste me bazë në Siri; Pastrimi i kontributeve të mbështetësve](#)

SHBA riatdheson 11 shtetas amerikanë nga Siria

Në muajin maj, Shtetet e Bashkuara kryen riatdhësimin më të madh të shtetasve amerikanë në një herë të vetme nga Siria verilindore, duke kthyer në vendin e vet 11 shtetas, duke përfshirë edhe pesë të mitur. Të gjithë shtetasit e riatdhesuar janë anëtarë të një familjeje. Megjithëse asnjë nga këta individë nuk ishte luftëtar i ISIS-it, një grua po përballet me akuzën e stërvitjes me ISIS-in jashtë vendit.

Së bashku me 11 shtetasit amerikanë, si pjesë e këtij operacioni riatdhësimi, në vendet e tyre u riatdhesuan edhe gjashtë shtetas kanadezë, katër holandezë dhe një finlandez.

Sekretari i Shtetit i Shteteve të Bashkuara, Antony Blinken, vuri në dukje se dhjetëra mijëra persona, " shumica e të cilëve janë fëmijë", nga më shumë se 60 vende të botës vazhdojnë të jenë ende në kampet siriane Al-Hol dhe Roj, dhe theksoi se "zgjidhja e vetme e qëndrueshme për këtë krizë humanitare dhe krizë të sigurisë në kampet e personave të zhvendosur dhe në objektet e paraburgimit në Sirinë verilindore është që këto vende të riatdhesojnë, të rehabilitojnë dhe t'i ri-integrojnë shtetasit e tyre, dhe sipas rastit, edhe t'i vënë para drejtësisë kur është nevoja." Më tej, Blinken i inkurajoi vendet e tjera që t'i riatdhesojnë shtetasit e tyre edhe nga Siria verilindore dhe theksoi se Shtetet e Bashkuara do të vazhdojnë t'i mbështesin ata në këtë përpjekje.

Burimi: [SHBA riatdheson 11 shtetas amerikanë nga Siria verilindore](#)

Raporti i Europolit: Propaganda xhihadiste online - 2022-shi në analizë

Në dhjetor 2023, Europol-i publikoi raportin e tij të pestë vjetor duke analizuar tendencat, temat dhe zhvillimet kryesore në propagandën e Shtetit Islamik (IS) dhe al-Kaedës, si dhe në degët e tyre në vitin 2022. Qëllimi i raportit është të rrisë ndërgjegjësimin dhe të kuptuarit se si organizatat xhihadiste dhe mbështetësit e tyre abuzojnë me teknologjinë për të shpërndarë mesazhet e tyre.

Sipas raportit, IS përdori mediat për të adresuar humbjen e lidershipit dhe për të përcjellë mesazhin se vdekja e dy kalifëve nuk do të ndikojë në funksionimin e Shtetit Islamik. Shteti Islamik shfrytëzoi gjithashtu vdekjet e liderëve për të mobilizuar mbështetësit dhe për t'i frymëzuar ata që të vazhdonin luftën, duke ndjekur shembullin e udhëheqësve të tyre. Pavarësisht ndryshimeve në udhëheqje, narrativat e Shtetit Islamik mbetën kryesisht të pandryshuara në vitin 2022. Raporti thekson se zëdhënësi i Shtetit Islamik nënvizoi lirinë e myslimanëve të burgosur dhe anëtarëve të IS si një përparësi për komandën e IS. Për të rritur moralin e mbështetësve dhe për të ilustruar forcën operacionale të IS, media e IS theksoi lirinë e mbështetësve të tyre nga burgjet në vitin 2022 në Siri, Nigeri dhe në Republikën Demokratike të Kongos. Propaganda e IS theksoi më tej përpjekjet e saj për t'u zgjeruar gjeografikisht dhe për të konsoliduar kontrollin territorial. IS mori përsipër autorësinë e 2058 sulmeve në vitin 2022. Megjithëse më shumë se 60 për qind e këtyre sulmeve kishin ndodhur në tre vende, Nigeri, Irak dhe Siri, raporti paralajmëron se numri i përgjithshëm i lartë i sulmeve së bashku me aftësitë operacionale relativisht të konsiderueshme të demonstruara gjatë lirimeve të mbështetësve nga burgu në Siri, mund të tregojnë se Shteti Islamik po e rimerr fuqinë në rajon. Gjithashtu, raporti paralajmëron se fakti që Siria mori më pak mbulim propagandistik mund të jetë pjesërisht për shkak të zgjedhjes strategjike të IS për të fshehur kapacitetin e saj aktual në Levant. Propaganda e IS-it bënte thirrje për migrim fetar në Afrikë, duke theksuar aftësitë e tij qeverisëse në disa pjesë të kontinentit dhe duke e paraqitur Afrikën si një destinacion për hixhra (migrim). Në Afganistan, strategjia e komunikimit e IS-it u fokusua tek pengimi i përpjekjeve të talebanëve për njohje ndërkombëtare, duke ekspozuar paaftësinë e talebanëve për të ofruar stabilitet dhe siguri në vend. Raporti vë në dukje se strategjia e komunikimit e IS-it i kushtoi rëndësi të madhe përkthimit të përmbajtjes propagandistike në shumë gjuhë, me

qëllim tejkalimin e barrierave gjuhësore dhe komunikimin me simpatizantë në mbarë botën. Sipas raportit, në vitin 2022 mesazhet e IS u përhapën në hapësira të ndryshme në internet duke përfshirë Telegram, Rocket Chat dhe në disa raste në platforma më të zakonshme si X, Facebook, Instagram dhe TikTok. IS përdori një platformë të decentralizuar të ndarjes së videove me burim të hapur Odysee, si dhe Sistemin Ndër-Planetar të skedarëve (IPFS) për të ruajtur dhe ndarë video dhe publikime të tjera mediatike. Propaganda e IS-it eksperimentoi me shfrytëzimin e shenjave jo të këmbyeshme (NFT) për të rritur elasticitetin e saj në internet. Raporti vë në dukje se "përdorimi i NFT-ve dhe teknologjive të tjera të decentralizuara për të shpërndarë përmbajtje xhihadiste paraqet sfida për zbatimin e ligjit në drejtim të heqjes së përmbajtjes" dhe se "ka gjithashtu gjasa të pengojë përpjekjet hetimore që synojnë identifikimin e operativëve të propagandës dhe administratorëve të rrjetit në platforma të decentralizuara."

Raporti i Europol-it vëren se rrjeti i Al-Kaedës dhe mediat mbështetëse të saj kanë mbështetur rrjedhën e mesazheve zyrtare të propagandës. Ashtu si IS, edhe Al-Kaeda përjetoi humbje lidershipi në vitin 2022, por kjo nuk u përkthye në ndryshime të narrativave dhe as nuk ndikoi në aktivitetet operacionale të organizatës. Me synimin për të krijuar perceptimin e organizatës si një lëvizje globale, aparati mediatik i Al-Kaedës i kushtoi hapësirë të konsiderueshme arritjeve të degëve të saj rajonale të cilat ishin aktive në disa vende duke përfshirë Somalinë, Kenian, Etiopinë, Malin, Burkina Fason, Benin, Togon, Algjerinë, Jemenin dhe Pakistanin. Përmbajtja mediatike që mbështet Al-Kaedën u shpërnda në faqet e internetit të Telegram, Rucker, GNews, Chirpwire dhe në faqe që shërbejnë për shkëmbime përmbajtjeje.

Në vitin 2022, strategjia e komunikimit e HTS-së kishte për qëllim ribrandimin e HTS-së si mbrojtësin e popullit sirian nga regjimi aktual dhe portretizimin e organizatës si "një alternativë politike duke hequr lidhjet me terrorizmin".

Burimi: [Propaganda Xhihadiste online - 2022 në Rishikim](#)

Xhihadistet femra përballë drejtësisë: Krahاسimi i qasjeve në Evropë, Pjesa III

Në janar 2024, Qendra Ndërkombëtare e Anti-Terrorizmit (ICCT) botoi librin "Femrat xhihadiste përballë drejtësisë: Krahاسimi i qasjeve në Evropë". Ky libër eksploron drejtësinë penale dhe përgjigjet e tjera ligjore ndaj ekstremistëve të dhunshme femra në Evropë, veçanërisht në Belgjikë, Francë, Gjermani dhe në Holandë. Në dy buletinet tona të mëparshme, ne përmbledhëm kapitujt e librit që shqyrtojnë qasjet ndaj ndjekjes penale të ekstremistëve të dhunshme femra në Belgjikë dhe Francë. Në këtë numër, ne ofrojmë një përmbledhje të kapitullit që eksploron përvojën e Gjermanisë për ndjekjen penale të ekstremistëve të dhunshme femra.

Sipas këtij kapitulli, gratë dhe vajzat përbëjnë një të katërtën e më shumë se 1150 individëve që kanë udhëtuar nga Gjermania drejt Irakut dhe Sirisë, kryesisht për të mbështetur të ashtuquajturin Shtet Islamik. Shumica e 129 grave në moshë madhore që janë kthyer deri tani, janë kthyer vullnetarisht dhe para rënies së të ashtuquajturit kalifat. Në Gjermani janë riatdhesuar gjithsej 27 gra. Disa gra mbeten ende në kampet e personave të zhvendosur ose në objektet e paraburgimit në Sirinë verilindore.

Deri më sot, Gjermania ka ndjekur penalisht gjithsej 35 ekstremiste të dhunshme femra për krime të lidhura me terrorizmin që kanë lidhje me Irakun ose Sirinë dhe procedimet penale kundër 13 grave të tjera janë në vazhdim. Analiza e akuzave të ngritura kundër ekstremistëve të dhunshme femra tregon se shumica e tyre janë ndjekur penalisht për anëtarësimin në një organizatë të huaj terroriste; vetëm 17 për qind e të pandehurave, disa prej të cilave nuk kanë udhëtuar drejt Sirisë, por kanë ofruar një lloj tjetër mbështetjeje për ISIS-in, janë dënuar për mbështetje të një organizate të huaj terroriste. Është interesante se shumica e ekstremistëve të dhunshme terroriste të proceduara, janë paditur dhe janë dënuar për disa kombinime të krimeve të terrorizmit dhe krimeve thelbësore ndërkombëtare ose krime të brendshme. Në pothuajse gjysmën e këtyre aktakuzave kumulative, të pandehurat janë akuzuar për krime thelbësore ndërkombëtare. Akuzat sipas ligjit të brendshëm përfshinin vepra penale që lidhen me fëmijët e tyre (të tilla si mospërmblidhja e detyrës së tyre të kujdesit dhe edukimit, dhe rrëmbimi i të miturve), përdorimi i paligjshëm i armëve, privimi i lirisë, trafikimi i qenieve njerëzore, shkaktimi i lëndimeve trupore dhe mosraportimi i një krimi. Shumica e të pandehurave janë dënuar pas gjyqimit ose procedimit në moshë të mitur. Vetëm 4.9 për qind e ndjekjeve penale janë mbyllur me marrëveshje për pranimin e fajësisë.

Mesatarja e dënimit me burg të dhënë ndaj ekstremistëve të dhunshme femra është katër vjet e tetë muaj e pesë ditë. Megjithatë, koha aktuale e kaluar në burg ka të ngjarë të jetë më e shkurtër për shkak të zbritjes së paraburgimit, provave dhe lirimeve të parakohshme.

Edhe pse numri i parë i madh i të kthyerve është regjistruar në vitin 2014 dhe 2015, procedimi sistematik i ekstremistëve të dhunshme të kthyer në Gjermani nuk filloi deri në vitin 2018. Kjo ishte për shkak të disa faktorëve. Së pari, në fillim dihejshin më pak detaje për rolet e tyre në ISIS. Së dyti, krimet që kanë kryer ekstremistët e dhunshme femra janë konsideruar më pak të rënda se krimet e kryera nga burrat. Së treti, autoritetet kishin vështirësi në zhvillimin e argumentimit të përshtatshëm ligjor në lidhje me pyetjen nëse përfshirja e grave përbënte marrje pjesë në terrorizëm. Hetimet zbuluan përfundimisht se edhe pse gratë gjermane në përgjithësi nuk ishin përfshirë në ndonjë aktivitet të dhunshëm, ato prapëseprapë e kishin mbështetur ISIS-in në mënyra të ndryshme. Kjo mbështetje përfshinte kujdesjen për familjet, lindjen e fëmijëve me synimin për të rritur brezin e ardhshëm në përputhje me ideologjinë e ISIS-it, përhapjen e propagandës me synim rekrutimin e grave të tjera (perëndimore) dhe mundësimin e udhëtimit të grave të tjera. Gjithashtu, në vendimin e saj historik të lëshuar në vitin 2018, Gjykata Federale Gjermane e Drejtësisë u shpreh se aktivitete të tilla si martesat me një luftëtar të ISIS-it dhe kujdesi për një familje në territorin e ISIS-it përbëjnë anëtarësim në një organizatë terroriste. Si rezultat i këtyre zhvillimeve pozitive ligjore, prokurorët u bënë më aktivë në sjelljen para drejtësisë të më shumë grave ekstremiste të dhunshme të kthyer, të cilat i kishin ofruar ISIS-it lloje të tjera mbështetjeje më thelbësore, edhe pse nuk ishin përfshirë në aktivitete luftarake.

Sipas librit të ICCT, marrja e provave ishte sfida kryesore në këto raste, sepse mbledhja e provave materiale nga skenat e krimit në Irak dhe Siri ishte praktikisht e pamundur. Në përgatitjen e këtyre çështjeve, forcat e rendit dhe prokurorët gjermanë u mbështetën në deklaratat e vetë dëshmitarëve dhe të pandehurve, në provat e marra përmes komunikimeve të monitoruara në internet, dëshmitë e ekspertëve dhe publikimet e ISIS. Ata përdorën edhe gjetjet e të ashtuquajturit hetim strukturor mbi krimet e kryera nga ISIS-i për të shpjeguar ngritjen dhe rënien e kalifatit dhe strukturës së ISIS-it. Këto hetime strukturore janë njohur si një mjet i rëndësishëm për vërtetimin e këtyre rasteve. Përveç kësaj, Ekipi Hetues i Kombeve të Bashkuara për Përgjegjshmërinë e Da'esh/ISIL (UNITAD) dhe mekanizma të tjerë të ngjashëm dhanë ndihmë të vlefshme në disa nga këto ndjekje penale.

Burimi: [T. Mehra et al. Xhihadistet që përballen me drejtësinë: Krahاسimi i qasjeve në Evropë](#)